



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1781/ 6 prot.

Datë 18.06.2026

V E N D I M
Nr. 827/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtare

Në mbledhjen e datës 18.06.2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “KMK Sh.p.k” & “Caushi M shpk” në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-83228-04-24-2026, me objekt “Ndërtim Segmenti Rruga Nato - Albanët & Ndërtimi i KUZ Bulevardi Nënë Tereza”, me fond limit 121,830,722.69 (njëqind e njëzet e një milion e tetëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e dy pikë gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues:

BOE “KMK Sh.p.k” me NUIS L78223801E, me adresë: Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090, Nr.Pasurie 7/9810/, Mallakstër & “Caushi M shpk” me NUIS L88419801O.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz, me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.04.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-83228-04-24-2026, me objekt “Ndërtim Segmenti Rruga Nato - Albanët & Ndërtimi i KUZ Bulevardi Nënë Tereza”, me fond limit 121,830,722.69 (njëqind e njëzet e një milion e tetëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e dy pikë gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 12.05.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 01.06.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE NDERTIMI shpk & SELAMI 72.762.598,00 I Kualifikuar
2. BONUS Sh.p.k 75.760.057,80 I Kualifikuar
3. 2 N 76.000.000,00 I Kualifikuar
4. KLAJGER KONSTRUKSION 76.181.070,00 I Kualifikuar
5. BAMI HOLDING 79.411.203,90 I Kualifikuar
6. COMPANY RIVIERA 2008 79.567.222,00 I Kualifikuar
7. ALMO KONSTRUKSION 80.598.599,00 I Kualifikuar
8. LIQENI VII 81.377.761,50 I Kualifikuar
9. SHPRESA – AL 81.555.442,50 I Kualifikuar
10. BOE NG STRUCTURES & TOTILA 81.648.104,62 I Kualifikuar
11. B93 II 83.124.031,20 I Kualifikuar
12. NDREGJONI 84.827.035,00 I Kualifikuar
13. L.T.E CONSTRUCTION 84.967.503,60 I Kualifikuar
14. BE - IS SH.P.K 88.645.118,00 I Kualifikuar
15. HASTOÇI 99.052.446,78 I Kualifikuar
16. Shendelli 108.868.106,00 I Kualifikuar
17. LIS KONSTRUKSION & KEGLI-DURI 80,735, 939.55 I Skualifikuar
18. K.TURJA 72,469,693.80 I Skualifikuar
19. K.M.K & Caushi M 71,660,400 I Kualifikuar

II.4. Në datën 02.06.2026, është publikuar në SPE njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt – ankimi, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 37, datë 08.06.2026, ku është shpallur fitues BOE NDERTIMI shpk & SELAMI.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, në datën 05.06.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1781/2026 protokolli, me datë 05.06.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6762 e BOE “KMK Sh.p.k” & “Caushi M shpk”, në procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE ankimues, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.1781/1 prot., datë 08.06.2026, lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

II.7. Me shkresën përcjellëse me nr. 6443/1 prot., datë 11.06.2026, është dërguar nëpërmjet adresës elektronike (email zyrtarë), Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave

(KSHA), me nr. 6443 prot., datë 11.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1781/2 prot., datë 12.06.2026, duke e **refuzuar** atë.

II.8. Me shkresën përcjellëse me nr. 6443/1 prot., datë 11.06.2026, është dërguar nëpërmjet shërbimit postar, Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), me nr. 6443 prot., datë 11.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1781/2 prot., datë 12.06.2026, duke e **refuzuar** atë.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE ankimues “KMK Sh.p.k” & “Caushi M shpk”, mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: ““-2.3.5 -Mungon Inxhinier Hidrogeolog. Dhe 2.3.8 - Mungon 1 (një) Specialist të çertifikuar për Shërbime Gjelbërimi (Kopshtarë)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.5 dhe 2.3.8. autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf mbështetës jo domosdoshmerisht të përfshirë në licencën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave konkretisht:*

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi Profili Infrastruktura Transport**
- **1 (një) Inxhinier Hidrogeolog**

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikues ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si më poshtë:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi Diplomë të shkollës mesme
- 1 (një) Teknik Topograf Diplomë të shkollës mesme
- 1 (një) Hekurkthyes Profesionale Çertifikatë trajnimi/Dëshmi
- 2 (dy) Karpentierë Profesionale Çertifikatë trajnimi/Dëshmi
- 2 (dy) Specialiste për vendosjen e bordurave Profesionale Çertifikatë trajnimi/Dëshmi
- 3 (dy) Specialiste për shtrim pllaka trotuari Profesionale Çertifikatë trajnimi/Dëshmi
- 2 (dy) Betonues Profesionale Çertifikatë trajnimi/Dëshmi
- 1 (një) Elektracist Profesionale Çertifikatë trajnimi/Dëshmi
- 1 (një) Hidraulik Profesionale Çertifikatë trajnimi/Dëshmi
- 2 (dy) Punëtorë Asfalti Profesionale Çertifikatë trajnimi/Dëshmi
- 1 (një) Specialist të çertifikuar për Shërbime Gjellbërimit (Kopshtarë) Çertifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale
- 4 (katër) Punëtorë të thjeshtë

Krahas formularit përmblendhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në DST, për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

nr.	emër mbiemër i punonjësit	profesioni	institucioni public/privat lëshues i certifikatës/diplomës	nr. i certifikatës/diplomës	nr nipt (në rast se lëshuesi është institucion privat)
1.					
2.					
etj.					

Shënim: Disponimi i stafit/punonjësve sipas specialitetit të kërkuar, duhet të deklarohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në seksionin përkatës të formularit përmblendhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse në dst, si dhe në rast se kualifikohet, përpara

publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten, dëshmi/ çertifikatë kualifikimi ose cdo dokument tjetër që vërteton diplomimin/trajnimin/ose kualifikimin e tyre sipas profesionit, të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara për kurset e ofruara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" për specialistët, ndërsa për teknikët duhet të paraqiten diplomat e shkollës së mesme/ ose të lartë.

III.1.2. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, në përpmbushje të pikës së sipërcituar në shtojcën e DT, BOE "KMK Sh.p.k" & "Caushi M shpk" në pikën B "Deklaratë" në seksionin "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate" dhe në pikën D "Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera", ka bërë deklaram, konkretisht kjo pjesë është ngarkuar në sistem si më poshtë vijon:

-Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të OE "KMK Sh.p.k";

B: DEKLARATE "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/ kontraktor.	Punonjës Po [☒] Jo [☐] Nëse, po, numri i punonjësve: ? i Punonjes per muajin Janar 2026 Punonjes per muajin Shkurt 2026 Punonjes per muajin Mars 2026 Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Z. [Emri i punonjës], me profesion Inxhinier Gjeolog, e punësuar pranë shoqërisë sone, në rolin e Inxhinierit Gjeologut/Drejtues Teknik me nr Diplome [Numri i diplomes] nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe të Minierave të Universitetit të Tiranës dega Gjeologjisë viti 1982 Z. [Emri i punonjës], me profesion Agronome, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Agronomes, me diplomë Nr. [Numri i diplomes] datë 02.07.1988 nga shkolla e mesme bujqesurore Kute. Me kontratë pune datë 01.01.2025

-Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të OE "Caushi M shpk";

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	Punonjës
Unë kam punonjës të nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/kontraktor.	Po [☒] Jo [☐]
	Nëse, po, numri i punonjësve:
	Janar 2026 është : Punonjes
	Shkurt 2026 është : Punonjes
	Mars 2026 është : Punonjes
	Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:
	Z. [] me profesion Inxhinier Gjeolog, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Inxhinier Gjeolog/Drejtnes Teknik, diplomuar ne Universitetin e Tiranës me Nr diplome [] nga Gjeologji.

-Marrëveshje bashkëpunimi (për bashkimin e operatorëve ekonomikë) datë 12.05.2026 midis palëve shoqëria “KMK Sh.p.k” dhe shoqëria “Caushi M shpk, ku referuar Nenit 3 “Pjesëmarrja” ku shoqëria “KMK” Shpk ka 83.9 % të pjesëmarrjes dhe fitimit ndërsa shoqëria “Caushi M” Shpk ka 16.1 % të pjesëmarrjes dhe fitimit. (tab.e ndarjeve të zërave të punimeve)

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e

duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të

ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

c) *personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

ç) *operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

d) *operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

dh) *operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve¹ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

e) *operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

ë) *operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

f) *operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

g) *operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

gj) *operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;*

h) *operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);*

i) *operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;*

j) *informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;*

k) *operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.*

3. *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.9. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

III.1.10. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka

në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.12. Komisioni konstaton, se BOE “K.M.K” SHPK & “Caushi M” SHPK, në përmbushje të kritereve sa më sipër, kanë dorëzuar:

- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të OE “KMK” shpk;
- Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të OE “Caushi M” shpk;
- Marrëveshje bashkëpunimi (për bashkimin e operatorëve ekonomikë) datë 12.05.2026 midis palëve shoqëria “KMK Sh.p.k” dhe shoqëria “Caushi M shpk, ku referuar Nenit 3 “*Pjesëmarrja*” ku shoqëria “KMK” Shpk ka 83.9 % të pjesëmarrjes dhe fitimit ndërsa shoqëria “Caushi M” Shpk ka 16.1 % të pjesëmarrjes dhe fitimit. (tab.e ndarjeve të zërave të punimeve)

Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar, është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në neni 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i

ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve në ofertën e paraqitur, ku janë përcaktuar zërat konkretë të punimeve, që do të kryeje secili nga anëtarët e këtij bashkimi dhe sasia në %. Në rastin konkret, referuar kontratës së bashkëpunimit, KPP konstaton se, anëtari i BOE, “KMK” Sh.p.k do të mbulojë 83.9 % të angazhimit të kontratës kryesore me Autoritetin Kontraktor, duke marrë përsipër për të realizuar punimet sipas kapitujve: punime prishje, ndërtim i veprave të artit + kanalizime, punime shtresash, punime gjurmimi, analiza teknike, punime të ndryshme, punime asfaltimi, sinjalet horizontale, punime betoni, punime hekur betoni, punime të ndryshme elektrike dhe sinjalisitika, ujesjellës kanalizimi i jashtëm, , instalime hidrosanitare dhe ngrohje, gaz e naftësjellës, instalime për ndricim, linjat T/L gjurmim i gropave të shtyllave, sinjalet dhe pajisjet shtesë, ngadalësuesit e shpejtësisë, analiza teknike të reja (dy zëra për mbjellje fidanësh) dhe analiza jashtë liste, për të cilat ka deklaruar në Formularin e Vetdeklarimit, se disponon stafin teknik sipas profileve të kërkuara në pikat 2.3.5 dhe 2.3.8 të DT, dhe në raport me % e punimeve të marra përsipër dhe për zërat specifiktë punimeve për të cilat ka marrë përsipër të realizojë, pra profilet si: 1 (një) Inxhinier Gjeolog dhe 1 (një) Specialist të certifikuar për Shërbime Gjellbërimit (Kopshtarë), të cilat shërbejnë për realizimin e punimeve të marra përsipër në raport edhe me natyrën dhe % e zërave të punimeve, sipas kontratës së bashkëpunimit. Anëtari i BOE, “Caushi M” Sh.p.k do të mbulojë 16.1 % të angazhimit të kontratës kryesore me Autoritetin Kontraktor, duke marrë përsipër për të realizuar punimet sipas kapitujve: ndërtim i veprave të artit + kanalizime, punime shtresash, punime gjurmimi, analiza teknike, punime të ndryshme, punime betoni, punime hekur betoni, punime të ndryshme elektrike dhe sinjalisitika, ujesjellës kanalizimi i jashtëm, gaz e naftësjellës, instalime për ndricim, linjat T/L gjurmim i gropave të shtyllave, dhe analiza jashtë liste, për të cilat ka deklaruar në Formularin e Vetdeklarimit, se disponon stafin teknik sipas profileve të kërkuara në pikat 2.3.5 të DT, dhe në raport me % e punimeve të marra përsipër dhe për zërat specifiktë punimeve për të cilat ka marrë përsipër të realizojë, pra profilet si: 1 (një) Inxhinier Gjeolog, i cili shërben për realizimin e punimeve të marra përsipër në raport edhe me natyrën dhe % e zërave të punimeve, sipas kontratës së bashkëpunimit. Referuar arsyes së pretendimit të BOE ankimes, konkretisht lidhur me pretendimet e tij për, stafin teknik pikat 2.3.5 dhe 2.3.8 të deklaruar nga BOE “KMK shpk” & “Caushi M shpk”, referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, KPP konstaton se, ky BOE ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), dokumentat si: marrëveshjen e bashkëpunimit, Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit për secilin anëtar të BOE, për të cilët në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontrator të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Pra, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, secilin anëtar BOE “KMK shpk” & “Caushi M shpk”, duhet të deklarojë për punonjësit (stafin teknik) të kërkuar, referuar profilin të punës, të kërkuara në kriteret e DT (pikat 2.3.5+2.3.8). Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) nga BOE “KMK shpk” & “Caushi M shpk”, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit të secilit anëtar të BOE, konstatohet, se në lidhje me plotësimin e kërkesave për (stafin teknik) punonjësit sipas profileve të kërkuara në pikat 2.3.5 dhe 2.3.8 të kriterëve të veçanata të kualifikimit, secili anëtar i BOE, ka deklaruar në pjesën III: *“Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika B Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate”, se disponojnë këto punonjës specialistë (stafi teknik) sipas profile respektive, të cituar edhe në dokumentat e pikës III.1.2, ku kanë deklaruar drejtuesit teknik si edhe specialistët e certifikuar sipas profesioneve, ku për secilin prej tyre ka deklaruar emrin, profilin e punës, si dhe kualifikimin. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se kërkesat në fjalë janë pjesë e kapacitetit teknik, referuar kjo dokumenteve standarde të tenderit, dhe të deklaruara në seksionin përkatës të secilit Formular të antërarëve të BOE, duke dhënë indicie dhe informacion mbi numrin dhe specialitetin e kërkuara sipas pikës 2.3.5 dhe 2.3.8. Kriteri i sipërpërmendur konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të dokumentave të tenderit objekt prokurimi. Dokumentacioni i kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor, sipas shtojcës nr.9.*

Gjithashtu, nga një korrespondencë e mëparshme midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, me shkresën nr. 319/1 prot., datë 19.01.2022 protokolluar me tonën nr. 2472/5 prot., 21.01.2022, Agjencia Prokurimit Publik njofton Komisionin e Prokurimit Publik ndër të tjera se: *[...] Kriteri për kualifikim mbi disponimin e punonjësve, duhet të përmbushet, nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST. Qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, **plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve, nëse do të jetë kërkuar, dhe profilin e tyre**, sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi [...].*

Nisur nga pretendimet e ankimesit, Komisioni gjykon se, punonjësit e deklaruar, kanë të evidentuar të dhënat si numrin e punonjësve si dhe profilin respektiv të kërkuar sipas pikave 2.3.5 dhe 2.3.8 të kriterëve të kualifikimit, deklaratë kjo e cila i shërben autoritetit kontraktor për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit, për këtë fazë, të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, duhet t’i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet

publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se, deklarimi i punonjësve të profilit sipas kërkesave të pikës 2.3.5 dhe 2.3.8 të DT në rubrikat përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit për secilin nga anëtarët e BOE ankimues, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell përmbushjen e kriterëve të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit në pikën 2.3.5 dhe 2.3.8 të kapacitetit teknik. Në përfundim të argumentimit të mësipërm, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga BOE ankimues, në procedurën e prokurimit në këtë fazë, e plotëson kërkesat 2.3.5. dhe 2.3.8 e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm në këtë fazë të procedurës.

Sa më sipër pretendimet e BOE ankimues “K.M.K.” SHPK & “Caushi M” SHPK qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e BOE ankimues “K.M.K.” SHPK & “Caushi M” SHPK mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “....*Mungon Katalogu: Tuba të brinjëzuar Ø 315mm, Ø 600mm dhe Ø 1000 mm (tubo plastike) Tuba betoni Ø 1500mm.....*” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.14. autoriteti kontraktor ka përcaktuar: **2.3.14 Operatori ekonomik ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar ne DST, per materialet si më poshtë:**

- a) Tuba të brinjëzuar Ø 315mm, Ø 600mm dhe Ø 1000 mm (**tubo plastike**)
- b) Tuba betoni Ø 1500mm
- c) Kesone betoni 2x2x1 m
- d) Bordura betoni

Duhet te paraqese:

Autorizim te Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, si dhe katalog. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit/katalogut ne gjuhe te huaj, ky dokument të paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “K.M.K.” SHPK & “Caushi M” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Autorizim prodhuesi nga “ARJEIL”shpk për tuba betoni Ø1500mm;
- Autorizim prodhuesi nga “Teqja INTERNATIONAL”sha për tubo plastik (Ø315mm, Ø600mm, Ø1000mm;
- Katalog prodhimi nga “Teqja INTERNATIONAL”sha;
- skedë teknike nga “ARJEIL”shpk për tuba betoni Ø1500mm;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve

teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.2.6. Në nenin 40 pika 6 germat b) dhe c) ,“Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b). fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c). dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto

dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.8. Referuar kriterit në pikën 2.3.14 të DT, autoriteti kontraktor ka kërkuar që *“a)Tuba të brinjëzuar Ø 315mm, Ø 600mm dhe Ø 1000 mm (tubo plastike) dhe b)Tuba betoni Ø 1500mm te paraqiten kataloget perkates”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga BOE ankimes, në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka dorëzuar *Autorizim prodhuesi nga shoqëria “Teqja Inernacional” sha; Autorizim prodhuesi Arjeil shpk e cila është prodhuese e tubove të betonit; Katalog prodhimi për tubot plasitke nga prodhuesi Teqja Inernacional sha, dhe skeda teknike per tub betoni nga prodhuesi Arjeil shpk për tub betoni 1500mm (ku evidentohet, diametri Ø-1500mm, materiali prej betoni, prerja terthore dhe gjatësore)*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE , DT, relacioni teknik, specifikimet teknike, preventivi dhe projekt zbatimi nga ana autoritetit kontraktor, KPP vëren se, është kërkuar f.v tuba të brinjëzuar HDPE me dimensione Ø 315mm, Ø 600mm dhe Ø 1000 mm dhe vendosje tombino rrethore Ø1500mm b/a, të cilët duhet të jenë në përputhje me masat dhe gjatësitë sipas projekt zbatimit kjo referuar asaj që është përshkruar tek specifikimet teknike kapitujt 6 dhe 7, por autoriteti nuk ka kërkuar specifikime teknike të veçanta në lidhje me këto materiale, me qëllim që të bëjë krahasueshmërinë midis katalogut të produktit të tubove prej betoni apo ato plastik, për të vërtetuar pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Referuar arsyes së skualifikimit të argumentuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me arsyetimin se, nuk ka deklaruar kataloget e produkteve sic kerkohet ne DST, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se BOE ankimes, në përmbushje të kriterit të mësipërm pika 2.3.14, ka dorëzuar katalogë për produktin tubo plastikë nga prodhuesi Teqja Inernacional sha, dhe skedën teknike nga prodhuesi Arjeil shpk nga i cili dalin të dhënat mbi specifikimet teknike të materialit tub betoni. Nga krahasimi i të dhënave që dalin nga katalogu dhe skeda teknike të dorëzuar nga BOE ankimes, me të dhënta që kërkohen nga autoriteti kontraktor, konstatohet se përmbushin kërkesën e autoritetit kontraktor për f.v.tubo plastike dhe tubo betoni. Komisioni vlerëson se qëllimi i autoritetit kontraktor lidhur me paraqitjen e katalogut të materialit tubo plastike dhe tubo betoni, është që operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë; dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, skeda teknike, shërben si provë e përputhshmërisë teknike të produktit të ofertuar me specifikimet teknike, pra tregon “çfarë karakteristikash ka produkti”. Akoma më tej, Komisioni gjykon se, në kushtet kur vetë autoriteti kontraktor nuk ka hartuar specifikime teknike të mirëfillta mbi materialin tubo plastik dhe betoni por vetëm një përshkrim narrativ të përgjithshëm, ka patur në dispozicion momentin e tij procedural,

për të kryer verifikime mbi skedën teknike/test raport të paraqitura nga ankimuesi me qëllim përmbushjen e kriterit të kërkuar. Pra, në përfundim të analizës së bërë më sipër, KPP gjykon se BOE ankimues, me dokumentacionin e paraqitur në SPE përmbush kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër pretendimet e BOE ankimues “K.M.K.” SHPK & “Caushi M” SHPK qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e BOE ankimues “K.M.K.” SHPK & “Caushi M” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-83228-04-24-2026, me objekt “Ndërtim Segmenti Rruga Nato - Albanët & Ndërtimi i KUZ Bulevardi Nënë Tereza”, me fond limit 121,830,722.69 (njëqind e njëzet e një milion e tetëqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e dy pikë gjashtëdhjetë e nëntë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi, duke kualifikuar BOE ankimiues.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “K.M.K.” SHPK & “Caushi M” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtare
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

